



SERVIZIO SANITARIO REGIONALE  
EMILIA-ROMAGNA

## Për të ditur më shumë

Mund të kontaktojmë mjekun tonë të familjes, në Këshillimoren familjare (Consultorio familiare) ose në Shërbimin e higjienës dhe të shëndetit publik (Servizio di igiene e sanità pubblica) të Ndërmarrjes shëndetësore lokale (Azienda Usl) në vendin ku banojmë.

Mundet gjithashtu të telefonojmë në numrin jeshil (falas) të Shërbimit shëndetësor rajonal (Servizio sanitario regionale)

Numri jeshil

**800 033033**

aktiv nga e hëna deri të premtën, nga ora 8.30 deri në 17.30  
dhe të shtunën nga ora 8.30 deri në orën 13.30  
ose të konsultojmë portalin e internetit të Shërbimit shëndetësor rajonal  
(Servizio sanitario regionale)

[www.saluter.it](http://www.saluter.it)

RAJONI EMILIA-ROMAGNA MERR PJESË NË FUSHATËN E VAKSINIMIT TË PROMOVUAR NGA OMS RAJONI EVROPIAN QË I DREJTOHET TË GJITHA GRAVE NË MOSHË PJELLORE PËR TË ELIMINUAR RUBEOLËN KONGJENITALE BRENDA VITIT 2015.

 Regione Emilia-Romagna



SERVIZIO SANITARIO REGIONALE  
EMILIA-ROMAGNA

# RUBEOLA

## PËRSE TË RREZIKOJMË?

### Vaksinimi mbron një jetë të ardhshme.

Fushata e vaksinimit falas, i drejtohet të gjitha grave në moshë riprodhuese për të parandaluar rubeolën (rozolinë) gjatë shtatzënisë.



Dicembre 2012 - Grafica: Tracce, Modena

 Regione Emilia-Romagna

## Çfarë është rubeola dhe çfarë mund të shkaktojë?

Rubeola është një sëmundje infektive që shkaktohet nga viruset. Në përgjithësi manifestohet me simptoma të lehta (temperaturë jo të lartë, fryrje të gjëndrave në qafë, shfaqje të njollave rozë mbi lëkurë) dhe ka një ecuri natyrëmirë, që nuk lë pasojë shëndetësore. Por në qoftë se merret gjatë shtatzënisë, në gratë që nuk janë vaksinuar ose që nuk e kanë pasur më përpara sëmundjen, virusi mund të kalojë pengesën e placentës, të infektojë fetusin dhe të shkaktojë dëme shumë serioze: dështim spontan, keqformime të zemrës, të syve e të organeve dëgjimore (rubeola kongjenitale).

Rreziku i infektimit të fetusit, ashtu si dhe pasojat e mundshme të sëmundjes, janë të lidhura ngushtë me momentin në të cilin gruaja shtatzënë është infektuar.

Nëse rubeola është marrë gjatë 10 javëve të para të

shtatzënisë, rreziku i dëmtimit të fetusit mund të arrijë deri në 85-90%; dhe ulet në 30% nëse infeksioni zhvillohet ndërmjet javës së 11-të dhe të 16-të; bie pothuajse në zero pas javës së 16-të. Nëse gruaja shtatzënë ka pasur rubeolën në të kaluarën, ose është vaksinuar, kontakti i mundshëm me virusin nuk përbën rrezik për fetusin, përveçse në raste shumë të rralla.

Për të qenë të sigurt se në të kaluarën e kemi pasur sëmundjen, është e nevojshme analiza e gjakut.

**Dëmtimet e mundshme ndaj fetusit nga rubeola e marrë në fillim të shtatzënisë:**

- abort spontan
- defekte në sy dhe në vesh
- keqformime të zemrës
- dëmtime të trurit
- dëmtime të mëllçisë dhe shpretkës
- dëmtime të kockave

## Parandalimi i rubeolës gjatë shtatzënisë

Gratë e moshës riprodhuese duhet të dinë nëse kanë qenë të vaksinuar ose nëse e kanë pasur sëmundjen, pra nëse ata janë të mbrojtura apo jo kundër virusit të rubeolës. Nëse nuk janë, këshillohet vaksinimi, që është e vetmja masë parandaluese. Të gjitha gratë shtatzëna duhet të kryejnë kontrolle për të përcaktuar nëse janë të mbrojtura nga virusi i rubeolës. Nëse ato nuk janë të mbrojtura, vaksinimi duhet të kryhet menjëherë pas lindjes për të mbrojtur nga rubeola kongjenitale fëmijët e ardhshëm.

**Nuk këshillohet vaksinimi gjatë shtatzënisë.**

Gratë në moshë pjellore (të moshës ndërmjet 15 dhe 44 vjeç), që i nënshtrohen vaksinimit, duhet të shmangin që të mbeten me barrë për një muaj.

## Vaksinimi

Vaksina përbëhet nga viruse të gjalla, të dobësuar, të paaftë që të shkaktojnë rubeolën (rozolinë) por në gjendje që të stimulojnë prodhimin e antitropave të efektshëm kundër infeksioneve.

Vaksina kundër-rubeolës jepet zakonisht së bashku me ato kundër fruthit dhe shytave, në një injeksion të vetëm (Mpr ose Trivalent).

Është e mjaftueshme vetëm një vaksinë e vetme për të siguruar mbrojtjen nga rubeola (rozolia) për një afat të gjatë në më shumë se 90% të grave të vaksinuar.

Ata që kanë marrë më përpara njërin nga të tre sëmundjet, mund të vaksinohen njësoj, pa pasur asnjë problem.

Vaksina tolerohet mirë dhe në pothuajse të gjitha rastet nuk shkakton reaksione. Shqetësimet e lehta për shkak të vaksinimit mund të përfshijnë:

ethe, ngacmim të lëkurës, fryrje të nyejve limfatikë në qafë; shumë më rrallë është e mundur shfaqja e dhimbjeve të artikulacioneve në një periudhë prej 1-3 javë pas vaksinimit. Edhe

më e rrallë është rënia e numrit të trombociteve (pllakëzave) brenda dy muajve pasardhës (trombocitopenia).

Megjithatë, të gjitha këto çrregullime janë kalimtare.

Reaksionet serioze alergjike janë të jashtëzakonshme si për të gjitha vaksinat e tjera.

## Parandalimi i lisë

Është e dobishme të dimë se lia, në qoftë se merret gjatë shtatzënisë mund të përbëjë një rrezik për fëmijën që do të lindë. Vaksinimi kundër lisë është falas për të gjitha gratë në moshë riprodhuese.

